



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:108157  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05627213

**PA1.nr.1123/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.L nga fshati ....., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.788-11/23 i dt.10.07.2023 të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, P.nr.144/23 të dt.01.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 22.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.Aprovohet** si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, **ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.144/23 të dt.01.06.2023, lidhur me vendimin mbi dënimin, ashtu që të pandehurit F.L për veprën penale për te cilën është shpallur fajtor i shqipton dënim me gjobë në shumën prej njëmijë (1000) euro, të cilën shumë duhet ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.05.2023 deri më 01.06.2023.

Ne pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pandryshuar

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, me aktgjykimin, P.nr.144/23 të dt.01.06.2023, të akuzuarit F.L , për shkak veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par. 1 të

KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 250 euro (dyqind e pesëdhjetë euro) të cilën duhet ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.05.2023 deri më 01.06.2023. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, dhe në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar.

E dëmtuara B.G lidhur me kërkesën pasurore- juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Prizren PP.II.nr.788-11/23 i dt.10.07.2023, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe ndaj të pandehurit F.L për veprën për të cilën është shpallur fajtor, ti shqiptoj një dënim meritor sipas Ligjit

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1159/23 të datës 11.09.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokuroria Themelore në Prizren, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit F.L , ti shqiptohet një dënim më i lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**-Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Prokuroria Themelore në Prizren e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal , me pretendimet se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në mënyrë jo të drejtë ka vendosur kur të pandehurit i ka shqiptuar dënimin në shumë prej 250 Euro, i cili dënim nuk përkon me peshën e veprës penale të kryer nga ana e të pandehurit. Prokurori i shtetit konsideron se ankesa nga kjo bazë nuk vë në pyetje gjendjen faktike të vërtetuar ose të drejtën e zbatuar, por vetëm dënimin e shqiptuar lidhur me veprën penale ngacmimi nga neni 182 par. 1 të KPRK-së, të cilin sipas prokurorit të shtetit gjykata nuk e ka caktuar drejtë, sepse për veprën penale të ngacmimit nga neni 182 par. 1 të KPRK-së, parashihet dënimi për kryesin me gjobë ose me burgim deri në 3 vite, kurse gjykata në këtë rast ka shqiptuar dënim prej 250 Euro. Tutje,

konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese, e po ashtu edhe ato rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, pasi që gjykata në rastin konkret nuk i ka vlerësuar fare rrethanat rënduese, duke theksuar se nuk ka gjetur rrethana rënduese, kurse nuk i ka vlerësuar si rrethana mesazhet nga i pandehuri drejtuar të dëmtuarës, nuk ka marrë parasysh as moshën e re të dëmtuarës si dhe mënyrën se si ka ndikuar kjo vepër penale në të. Prokurori i shtetit konsideron se me dënimin e shqiptuar nuk do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë në dispozita ligjore, respektivisht konform nenit 38 të KPRK-së, e po ashtu se dënimi i shqiptuar nuk është në harmoni me insitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur me dispozita përkatëse ligjore si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se nuk është në shërbim të preventivës së përgjithshme, e as preventivës individuale, në forcimin e moralit të shoqërisë dhe me këtë dënim nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, sepse çështja e qëllimit të dënimit, sikurse edhe çështja e bazës juridike të dënimit, duhet të përmbush edhe qëllimin e drejtësisë, pra duhet të jetë i drejtë. Pra, prokurori i çështjes pas vlerësimit dhe shqyrtimit me vëmendje të aktgjykimit, konsideron se gjykata nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë nenin 369 par. 7 të KPP-së, dhe në rastin konkret është shkelur edhe neni 7 i KPP-së që detyrimisht obligon secilin organ aktiv në procedurën penale, që tërësisht dhe saktësisht të vërtetoj të gjitha faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prizren janë të bazuara. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku për të pandehurin duke mos gjetur rrethana rënduese e që si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm e akuzuarit me gjykatën, e veçanërisht pendimin e sinqertë të të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Një konstatim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, mirëpo kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese ndërsa rrethanat rënduese nuk i ka vlerësuar në masën e duhur. Kolegji vlerësoi se është e vërtetë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë mirëpo ky fakt nuk mund të vlerësohet deri në këtë masë që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim i ulët si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kjo për shkak të rrezikshmërisë së veprës penale dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga kjo gjykatë si në dispozitiv të këtij aktgjykim, andaj marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar

është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.1123/23, më datë 22.04.2024**

**Procesmbajtësja,**  
Gentijana Manaj-Gashi

---

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

---

**Kryetar i kolegjit,**  
Ferit Osmani

---

Zyhdi Haziri

---